



Data:
18.05.2026

Vendi:
Prishtinë

Nr. Prot:
05/05

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, përkatësisht nenit 35 paragrafi 2 dhe 3, në përputhje me Statutin e Komitetit Paralimpik të Kosovës, neni 15 paragrafi 3 si dhe, në bazë të vendimit të Bordit Ekzekutiv të datës 29.12.2024, përmes të cilave përcaktohet e drejta e organizatës për të menaxhuar dhe disponuar me pronën dhe asetet e saj, Komiteti Paralimpik i Kosovës shpall:

SH P A L L J E P U B L I K E

Komiteti Paralimpik i Kosovës shpall thirrje publike për shitjen e dy veturave të përdorura, të pranuar si donacion, përmes procedurës së ofertimit publik.

I. ***Përshkrimi i veturave***

Shiten gjithsej 2 vetura:

- 1: Nissan Pathfinder SE 2.5 TDI, Viti i prodhimit: 2009, Kilometrazhi: 49465, Karburanti: Diesel, Transmisioni: Manual, Numri i ulëseve: 7
- 2: Nissan Pathfinder SE 2.5 TDI, Viti i prodhimit: 2009, Kilometrazhi: 130274, Karburanti: Diesel, Transmisioni: Manual, Numri i ulëseve: 7

II. ***Gjendja e veturave***

Veturat shiten në gjendjen aktuale në të cilën ndodhen, pa garanci dhe pa përgjegjësi nga shitësi.

III. Çmimi fillestar

Çmimi minimal për një veturë është:

2,800.00 Euro

IV. ***Inspektimi i veturave***

Të interesuarit mund të bëjnë inspektimin fizik të veturave në:

19.05.2026 nga ora 14:00 deri në 16:00 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri

më datë: 21.05.2026

nga ora: 14:00 deri në 16:00

V. ***Dorëzimi i ofertave***

Ofertat duhet të dorëzohen deri nga data

Nga: 18 maj 2026

Deri: 25 maj 2026 orë 00:00



në email: info@kosovaparalympics.com

Oferta duhet të përmbajë:

- Emrin dhe mbiemrin / emrin e kompanisë
- Numrin e telefonit
- Çmimin e ofruar
- Specifikimin për cilën veturë aplikohet

VI. ***Përzgjedhja e fituesit***

Fitues shpallet ofertuesi me çmimin më të lartë për secilën veturë.

VII. ***Pagesa dhe transferimi i pronësisë***

Fituesi është i obliguar të kryejë pagesën brenda 5 ditëve pune nga njoftimi.
Transferimi i pronësisë bëhet pas përfundimit të pagesës.

Për informata shtesë:

info@kosovaparalympics.com

Komiteti Paralimpik i Kosovës

“Totali i mjeteve financiare të realizuara nga ky ankand do të përdoret ekskluzivisht për realizimin e qëllimeve dhe aktiviteteve jofitimprurëse të Organizatës Joqeveritare Komitetit Paralimpik të Kosovës”